

VENDIM
Nr.841, datë 13.12.2006

**PËR PAGESËN E ANËTARËVE, NË PËRBËRJE TË KOMISIONEVE PËR VLERËSIMIN,
MIRATIMIN DHE CERTIFIKIMIN E TEKSTEVE SHKOLLORE DHE TË MATERIALEVE
TË TJERA NDIHMËSE, NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, 52 e 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Anëtarët, në përbërje të bordit të miratimit të teksteve shkollore, për periudhën e veprimtarisë së bordit, të paguhen me 30 për qind të pagës mujore të “Doktorit të Shkencave”, në universitetet dhe shkollat e larta, ndërsa kryetari i bordit me 30 për qind të pagës mujore, të “Profesorit”, në universitetet dhe shkollat e larta.

2. Vlerësuesit e teksteve, të aktivizuar për kryerjen e procesit të vlerësimit, miratimit dhe certifikimit të teksteve shkollore, të paguhen, përkatësisht, sipas punës (për çdo tekst), po jo më shumë se 3 persona për secilën kategori vlerësimi:

- | | |
|---|-------------|
| a) Për vlerësim shkencor | 4 000 lekë; |
| b) Për vlerësim gjuhësor | 3 000 lekë; |
| c) Për vlerësimin e metodologjisë | 3 000 lekë; |
| ç) Për vlerësim dizanji | 1 500 lekë; |
| d) Për vlerësim krahasues të njëjtësisë dhe ndryshimeve | 1 000 lekë. |

3. Specialistët a punonjësit, e thirrur pranë bordeve, komisioneve apo grupeve të punës, me kërkesë të bordit të miratimit të teksteve, për mbështetje teknike dhe veprime sekretarie, në periudhat e miratimit të teksteve, të paguhen, sipas normave, për punën e kryer jashtë kohës normale të punës.

4. Masa e pagesës për të gjithë personat e aktivizuar në këtë proces miratohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe përballohet nga buxheti i shtetit, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha